



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:219717

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06711599

KPPP.nr. 1214/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Sallahu” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810135237 dhe seli në Bicec, Kaçanik, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 672/24, i lejuar me datë 23.07.2024, nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka me seli në Kaçanik, jashtë seancës me datën 15.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ashtu që Urdhri përmbartimor P.nr. 672/24, i lejuar me datë 23.07.2024, nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Sallahu” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës MVD IN 04-023, e datës 16.06.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 672/24, të datës 23.07.2024, me të cilin është urdhëruar debitori Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që t’ia paguajë kreditorit borxhin shumë prej EUR 5,386.00. me kamatë ligjore prej 8 % në vit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se duke theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk i

plotëson elementet e përcaktuar në nenit 27 të LPP-së dhe rrjedhimisht nuk mund të shërbej si dokumenti i përmbarueshëm pasi që nuk është treguar koha e përmbushjes, detyrimi si dhe objekti. Më tej, ka theksuar se fatura është lëshuar për kompensimin për inflacion e jo mbi bazën e punëve të realizuara sipas kontratës, andaj kjo nuk është bazë për faturim pasi që kërkesa për kompensim lidhur me projektin “*Mirëmbajtja Verore dhe Mirëmbajtja dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale për vitin 2021/2022 Ferizaj*”, me vendimin e datës 31.07.2023 është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa ka shtuar se propozimi për përmbarim është bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së, dhe se debitori në mënyrë të rregullt dhe pa vërejtje ka pranuar faturën së bashku me kërkesë për kompensim të inflacionit të cilat i janë përcjellë për pagesë përmes menaxherit të kontratës të përcaktuar nga debitori. Ka shtuar se fatura i përmban të gjitha elementet e përcaktuar anë nenin 27 të LPP-së dhe se e njejta është në përputhje edhe me Ligjin për mbështetjen e punëve publike. Në fund, ka theksuar se sa i përket vendimit me të cilin refuzohet kërkesa e kreditorit për kompensim, kreditori është njoftuar për këtë vetëm në momentin e pranimit të prapësimin dhe se ky vendim nuk i është dorëzuar më parë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të*

besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit".

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Faturë nr. MVD-IN 04-023 e datës 16.06.2023, mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri për përmbaram ndaj debitorit, nuk është e përshtatshme për përmbaram dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbaramit. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga provat e bashkëngjitura nga debitori në prapësim, përkatësisht nga Vendimi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nr. 6187, i datës 31.07.2023, rezulton se kërkesa e kreditorit për pagesën e shumës prej EUR 5,386.00 sipas faturës nr. MVD-IN 04-023 të datës 16.06.2023 në emër të inflacionit, është trajtuar dhe është refuzuar nga debitori në procedurë administrative.

Në këtë drejtim, me vet faktin se debitori ka refuzuar pagesën prej EUR 5,386.00 sipas faturës nr. MVD-IN 04-023 e datës 16.06.2023 në procedurë administrative, dhe atë para inicimit të kësaj procedure përmbaramore, rezulton se fatura në fjalë, tanimë nuk mund të trajtohet si dokument i përshtatshëm për përmbaram në mungesë të tipareve të përmbaramueshmërisë. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 71, pika 1.1. të LPP-së me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse "*dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbaram ose urdhri përmbaram, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbaramueshmërisë*", gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Megjithatë, vendosja në këtë çështje përmbaramor nuk paraqet pengesë për kreditorin që pretendimet e tij eventuale ndaj debitorit, t'i realizoj në procedurë të rregullt civile pranë gjykatës kompetente.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1214/24, datë 15.01.2025

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.